



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 265, Datë 14.10.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DIMAX ALBANIA”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1799/5 prot., datë 12.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “DIMAX ALBANIA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DIMAX ALBANIA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1749 prot., datë 03.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).

- Aplikuesi ka derdhur për llogari të ERE-s një shumë më të madhe se sa është përcaktuar në Aneksin A të rregullores, ndaj pagesa shtesë do t'i kthehet në vijim.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi aplikimi rezulton se shoqëria “DIMAX ALBANIA” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pikës 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; pikës 1.2, gërmat “a” dhe “d”; pikës 1.3, gërmat “b” dhe “c”; pikës 2.1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:
Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ
 - **gërma “b”:** Aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin për gjendjen gjyqësore (dëshmi penaliteti) për vetë shoqërisë “DIMAX ALBANIA” sh.p.k.
 - **gërma “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë informacion mbi funksionet që kryen cdo departament i strukturës organizative në lidhje me veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.*Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*
 - **gërma “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE, vërtetimin mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve tatimore, i cili nuk duhet të jetë lëshuar më parë se 1 muaj nga paraqitja e aplikimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DIMAX ALBANIA” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW për një afat 25-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI